



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
NJESIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM**

Nr. ____ .Prot

Kuçovë, më ____ / 10 / 2025

**M I R A T O I
KRYETARI I BASHKISE
Kreshnik HAJDARI**

**PLANI STRATEGJIK DHE VJETOR I NJESISE SE AUDITIMIT TE BRENDSHEM,
PER PERIUDHEN 2026 - 2028**

HYRJE

Ne zbatim te ligjit nr.114 dt. 22.10.2015 “Per auditimin e brendshem ne sektorin publik” te ndryshuar, ne respektim e reflektim te Standardeve Globale te Auditimit te Brendshem, te miratuar me Urdherin e Ministrit te Financave nr.103 date 23.07.2025, duke siguruar perputhje me kerkesat normative te Manualit te Auditimit te Brendshem ,te miratuar me Urdher te Ministrit te Financave nr.100 dt.25.10.2016, si dhe ne mbeshtetje te ligjit 139/2015 date 17.12.2015 “Per veteqeverisjen vendore” dhe akteve te tjera ligjore dhe nenligjore te cilat rregullojne e normojne veprimtarine e auditimit te brendshem ne sektorin publik, eshte hartuar: Plani Strategjik per vitet 2026 - 2028 dhe Programi Vjetor i veprimtarise se Njesise se Auditimit te Brendshem te Bashkise Kuçove per vitin 2026.

Ne hartimin e tij eshte mbajtur parasysh perditesimi i universit te auditimit ne ndryshim, ripercaktimi i fushave apo sistemeve qe do te duhet te auditohen mbi baze te riskut, perdorimit te metodeve e teknikeve te pershtatshme te auditimit, per te qene sa me eficente ne vleresimin e sistemit te menaxhimit te riskut si nje proces i vazhdueshem, ekzistences dhe funksionimit te proceseve te kontrollit dhe menaxhimit financiar,me synimin per permiresimin e veprimtarise dhe arritjen e objektiveve te administrates se bashkise Kucove.

Ne procesin e hartimit te Planit Strategjik 2026-2028 dhe atij Vjetor per vitin 2026 te veprimtarise se auditimit per Bashkine Kuçove, kemi vleresuar dhe mbajtur ne konsiderate permbushjen e kerkesave qe adresohen me shkresën e Drejtorise se Harmonizimit te Auditimit te Brendshem, Ministria e Financave me nr.13111 Prot, datë 10.09.2025, protokolluar me tonën me nr.3185 Prot. datë 18.09.2025.

I. PLANI STRATEGJIK I NJ.A.B KUCOVE 2026 - 2028

Plani Strategjik i veprimtarise se auditimit te NJAB Kucove per vitet 2026-2028 eshte hartuar ne mbeshtetje te ligjit nr.114/2015 *“Per Auditimin e Brendshem ne sektorin publik”* te ndryshuar , ne reflektim te Standardeve Globale te AB, miratuar per veprim me Urdherin nr.103 te Ministrit te Financave, ne zbatim te percaktimeve te normuara te Kapitullit III te Manualit te Auditimit te Brendshem. Per hartimin e ketij Plani jemi bazuar ne organiken e NJAB Kucove te miratuar, ne nivelin profesional te burimeve njerezore qe disponohen ne pervojen e veprimtarise audituese ne vite, si dhe eshte diskutuar paraprakisht me Kryetarin e Bashkise Kuçove dhe eshte rene dakord me te. Gjithashtu jane bere perpjekje ne identifikimin e sistemeve te fushave prioritare e me risk te larte operacional e menaxherial.

Hartimi i Planit Strategjik 2026-2028 është kryer sipas kësaj strukture :

- Qëllimi i Planit Strategjik dhe Misioni i NJAB
- Organizimi i NJAB dhe kuadri ligjor
- Objektivat strategjike te NjAB ne funksion te Objektivate strategjike te bashkise :
- Identifikimi i subjekteve(Universi i auditimit)
- Identifikimi i fushave /sistemeve prioritare
- Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve(klasifikimi i subjekteve mbi baze risku)
- Kufizimet e Auditimit
- Prioritet për tre vitet 2026-2028

Qëllimi i Planit Strategjik dhe Misioni i NJAB

-Qëllimi i Planit Strategjik.

Plani Strategjik i NJAB përfaqeson nje nga dokumentat më të rëndësishme të veprimtarise se auditimit të brendshëm në Bashkisë Kucove..

Qëllimi i Planit Strategjik per veprimtarine e auditimit te brendshem per periudhen 2026-2028, eshte te percaktoje pikesynimet dhe drejtimet ne te cilat do te zhvillohet veprimtaria audituese ne kete bashki, kohen dhe burimet e nevojshme per realizimin e objektivate te synuara.

Hartimi i ketij Plani Strategjik i veprimtarise se auditimit, mbështetet në objektivat strategjike te vendimuar te Bashkisë, me prioritet dobishmerine e sherbimit te auditimit ne arritjen e rezultateve te synuara dhe permbushjen e pritshmerise se Menaxhimit te larte te bashkise..

NJAB mbi bazën e njohjes dhe pervetesimit të objektivate strategjike dhe vleresimit të sistemeve te kontrollit te brendshem të Bashkisë dhe njesive te saj te varesise, si dhe bazuar në identifi kimin,ne vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve që ndikojnë në realizimin e objektivate të kësaj njësie publike evidenton subjektet,sistemet apo dhe fushat e auditimit që do realizohen në 3 vitet e planifikimit strategjik afatmesëm si dhe frekuencën e realizimit të këtyre auditimeve.

NJAB Kucove nëpërmjet hartimit dhe shume e rëndësishme te zbatimit të planit strategjik të auditimit, ka per qellim te ndihmoje bashkine Kucove në realizimin e objektivate strategjike, duke vleresuar e permiresuar veprimtarine e menaxhimit te risqeve, aktiviteve te kontrollit dhe qeverisjes se mire.

-Misioni i NJAB.

NJAB ka si mision të japi siguri të arsyeshme Kryetarit të Bashkisë në mënyrë të pavarur dhe objektive si dhe të ofrojë këshillim për përmirësimin e veprimtarisë së bashkisë dhe efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, duke u fokusuar kryesisht në : Identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga ana e Bashkisë ; përputhshmërinë e veprimtarisë me kuadrin ligjor, ruajtja e aseteve; në besueshmërinë e gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional në kryerjen e veprimtarisë së njësive publike me ekonomi , efektivitet dhe eficiencë, në përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve, në dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit dhe ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna .

NJAB realizimin e këtij misioni e kryen mbështetur në parimet kryesore të auditimit: Të ligjshmërisë, paañsisë, integritetit, pavarësisë dhe objektivitetit, profesionalizmit dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional, kompetencës, konfidencialitetit si dhe mbi bazën e Standarteve Globale të Auditit të Brendshëm, të Kartës së Auditit të Brendshëm si dhe të Kodit Etik të audituesve të brendshëm në sektorin publik.

Organizimi i NJAB dhe Kuadri ligjor

-Organizimi i Njesise se Auditimit te Brendshem ne bashkine Kucove :

Njesia e Auditimit te Brendshem është e pjese integrale e administrates se Bashkisë Kucove, kjo sipas ligjit organik nr.139/2015 “Per Veteqeverisjen Vendore” i ndryshuar. Per vitin 2025 struktura e kesaj njesie eshte vendimuar me VKB nr.71 datë 23.12. 2024 “ Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelit të pagave te administrates se bashkise Kucove per vitin 2025”, me emërtesë “Sektori i Auditimit të Brendshëm” dhe me strukture te perbere prej 3(tre) punonjesish sipas :1(nje) Pergjegjesi i Sektorit dhe 2(dy) specialiste auditues. Ky sektor eshte në varësi të drejtperdrejte te Kryetarit te Bashkisë Kucove(eshte zbatuar parimi i pavaresise funksionale) .

NJAB bashkia Kucove e ka realizuar veprimtarinë audituese, bazuar në “Programin vjetor të auditimit të vitit 2025” të miratuar nga Kryetari i Bashkisë me dokumentin nr. 3501 prot dt 17.10.2024, ku një kopje e këtij programi te miratuar është dërguar pranë DH/AB ne Ministrine e Financave.

-Kuadri Ligjor

NjAB Kucove realizon funksionin e vet ne zbatim të kërkesave të ligjit nr.114/2015 dt 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” te ndryshuar , konform Standardeve Globale te Auditimit te Brendshem, miratuar me Urdherin e Ministrit te Financave nr.103 date 23.07.2025, metodologjise e teknikave te percaktuara ne “Manualin e auditimit të brendshëm”, në respekt te percaktimeve te ketij sherbimi ne ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetë qeverisjen vendore”, si dhe në vleresim koherent me të gjitha dispozitat ligjore e nenligjore që normojne e rregullojne funksionimin e veprimtarisë së fushes të auditimit brenda institucionit të Bashkisë dhe njesive te saj te varësisë.

Objektivat strategjik të NJAB Kucove per vitet 2026-2028

- ✓ Të ndihmojë menaxhimin e Bashkise Kucove, në arritjen e objektivave të vendimuara , duke përmirësuar sistemet dhe shërbimet qe ofron ky institucion.
- ✓ Realizimin e detyrave te parashikuara e te programuara ne Planin Strategjik me kapacitetin e burimeve qe disponon dhe me kompetencen profesionale ne dinamike
- ✓ Të japë siguri objektive tek menaxhimi i Bashkise mbi saktësinë dhe besueshmërinë e raporteve financiare dhe raporteve të performancës, të përgatitura nga strukturat e njesive shpenzuese, nepermjet auditmeve financiare dhe te kombinuara.
- ✓ Kryerja e veprimtarise se pavarur, objektive e profesionale dhe te bazuar ne vleresimin e identifikimit dhe menaxhimin e riskut.
- ✓ Dhenien e sigurise objektive per menaxhimin ne lidhje me funksionimin e sistemit te kontrollit te brendshem ne njesite qe do te auditohen.
- ✓ Te respektoje gjate kryerjes se veprimtarise, Kodin e Etikes te audituesit te brendshem miratuar me Urdherin e Ministrit te Financave.
- ✓ Te ndihmoje menaxhimin e njesive shpenzuese per rritjen e pergjegjshmerise ndaj detyrimeve ligjore e publikut, duke vleresuar pershtatshmerine dhe efektivitetin e sistemeve, strukturave, procedurave dhe kontroleve, perputhshmerine e akteve te brendshme te nxjerra , me legjislacionin perkates.
- ✓ Të ushtroje veprimtari auditimi te sigurise si dhe ofroje keshillime ne kuader te minimizimit te mundësisë për mashtrim, shpërdorim , abuzim dhe keq perdorim te fondeve e asetëve.
- ✓ Monitorim ne vazhdimesi i implementimit te rekomandimeve te dhena e te pranuar, per tu siguruar qe veprimet korrektuese po zbatohen dhe po sjellin permiresim te situates se konstatuar.
- ✓ Zhvillimi profesional i vazhdueshem i stafit dhe motivimi i tij.

Vizioni i NjAB është ti shtojë vlerë reale Bashkise Kucove, duke siguruar përdorimin e fondeve publike me efektivitet, ekonomi dhe eficiency.

Identifikimi i subjekteve

Për periudhën 2026-2028, bazuar ne njohjen dhe marrjes ne konsiderate te rishikimit te Universit te auditimit per bashkine Kucove, ne kuader te analizimit dhe vleresimin e risqeve si dhe nevojës per te siguruar mbulimin me auditim te njesive/strukturave/fushave dhe veprimtarive te cilat kane perparesi, nga NjAB Kucove jane parashikuar që të auditohen 17 subjekte perberese konkretisht : Njësia Admin Kozare, Njësia Admin Lumas, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Drejtoria e Financës, Njesia Admin.Perondi, Njësia e Prokurimit Publik, Dr.Planifikim&Zhvillim te teritorit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Zhvillimit Rural, Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerezore, Qendra Ekonomike e Arsimit, Agjensia Sherbimit Komunal,Spektori i Koordinim dhe Zhvillimit, Policia Bashkiake, Inspektoriati i Mbrojtjes se Territorit, Qendra Kultureore “Fenix”.

Identifikimi i fushave /sistemeve prioritare

NJAB Kucove, realizimin e auditimeve si të subjekteve ashtu dhe të fushave të auditimit do ta kryej mbi bazën e auditimit të sistemeve, konkretisht me kryesoret jane:

- Auditimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm
- Auditimi i sistemit të programimit dhe zbatimit të buxhetit.
- Auditimi i sistemit të prokurimeve publike.
- Auditimi i sistemit të kontabilitetit dhe i pasqyrave financiare.
- Auditimi i sistemit të pagesave, **të detyrimeve të prapambetura.**
- Auditimi i sistemit të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore,. **dhe ndjekja e debitorëve**
- Auditimi i sistemit të burimeve njerëzore.

Planifikimi i Auditimit me bazë sistemi ,është bërë duke pasur parasysh anën funksionale, organizative të subjekteve, këshillat dhe opinionet e drejtuesëve të këtyre subjekteve, raportet dhe pasqyrat financiare, raportet vjetore zyrtare, raportet e mëparshme të auditit të brendshëm , rekomandime e auditit te jashtëm (K.L.Sh), me objektivin se auditimi me baze sistemi është më efektiv në veprimtarinë audituese, ku zbulohen të metat dhe mangësitë e subjekteve të audituara dhe ndërmerren veprime korigjuese.

Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve.

Në Planifikimin Strategjik dhe Vjetor të auditimit te brendshëm , NjAB një rëndësi të veçantë i ka kushtuar, vlerësimin identifikimit dhe menaxhimit të risqeve.

Mbështetur në vlerësimin e mjedisit të subjekteve që do të auditohen, ekzistences dhe funksionimit te sistemit te menaxhimit financiar dhe kontrollit,si dhe bazuar në raportet e mëparshme të auditimit, të brendshëm dhe të jashtëm, është përcaktuar shkalla e riskut per çdo subjekt dhe fushë auditimi.

Gjatë planifikimit të auditimeve për periudhen 2026-2028, NJAB Kucove ka marrë në konsideratë risqet potenciale me të cilat përballen proceset gjatë auditimit, duke ju kushtuar kohë dhe angazhim më shumë atyre subjekteve dhe fushave auditimi që kanë risqe të lartë, konkretisht : (Prokurimet Publike, Drejtoria Financës, Drejtoria Taksave , Auditimi i pagesave të prapambetura, auditimi i Agjensise Komunale, si ndërrmarje me rendesi e nivel te larte risku).

NJAB Kucove, për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve të subjekteve të planifikuara për auditim është mbështetur edhe tek funksionimi i sistemeve brenda subjekteve, konkretisht :

- Sistemi i të ardhurave nga Taksat dhe Tarifave Vendore ka risk të lartë për arsye se, mos realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, ka impakt te larte, pasi ndikon drejtperdrejt ne realizimin e shpenzimeve e investimeve te programuara dhe si rrjedhoje risku është i lartë .
- Risqet në sistemin e programimit dhe zbatimit të buxhetit janë të lartë, impakti eshte i lartë dhe risku eshte i lartë.\

- Agjensia e Shërbimit Komunal për vetë faktin si ndermarje në shërbim e në mardhenie të drejtperdrejt me komunitetin, për natyrën e kompleksitetin e veprimtarisë që ushtron, për problemet komunitare që hasen çdo ditë, të procedurave të realizuara si dhe të pagesave të kryera ndaj të treta për blerje bazë materiale apo kontratave perkatëse, paraqitet me nivel risku të lartë financiar dhe reputacioni.

- Në sistemin e prokurimeve publike, si rrjedhim i problemeve në përcaktimet të fondeve limit, të anomalive në hartimin e projekt- preventivave, të gabimeve që mund të ndodhin në vlerësimin e ofertave, ndjekjes e zbatimit të afateve të kontratave, kryerjes së punimeve sipas projekteve dhe preventivave, impakti social ekonomik është i lartë e si rrjedhim niveli i riskut është i lartë.

- Në sistemin e kontabilitetit e të pasqyrave financiare, Nj.A.B vlerëson risk të lartë por me ndikim të ulët të nivelit të riskut, për arsye se kontabiliteti është i mirë organizuar me sistem të integruar dhe personel të kualifikuar dhe përvojë pozitive e funksionimit.

Njeheresh për çdo vit ushtrohen kontrollle nga grupet e auditimit të KLSH-se, specifikisht në fushën financiare, si rrjedhim mundësia e ndodhjes së gabimeve është e ulët, impakti i riskut është i ulët dhe niveli i ndikimit të riskut në këtë sistem është i ulët.

Kufizimet e Auditimit

NJAB e Bashkisë Kucove në veprimtarinë e auditimit të brendshëm kanë pasur parasysh edhe kufizimet ligjore të auditimit, dhe konkretisht:

- Audituesit nuk kryejnë asnjë funksion tjetër në veprimtarinë menaxheriale e operative të Bashkisë apo të Njësive të Varësisë përveç veprimtarisë audituese.

- Auditët nuk janë të zgjedhur në funksione drejtuese të strukturave të partive politike.

- Auditët nuk kryejnë asnjë veprimtari tjetër me pagesë brenda subjektit që ushtrojnë veprimtari audituese.

- Auditet në çdo rast që kanë konflikt interesi me subjektet që auditohen, përjashtohen nga kryerja e angazhimit të auditimit në atë subjekt.

Prioritet për vitet (2026 - 2028)

NJAB Kucove, me hartimin dhe nepermjet zbatimit të Planit Strategjik e Vjetor ka si prioritet të kontribojë për permiresimin dhe mirefunksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar me projeksionin final, permbushjen e objektivave të vendimuara.

Prioritetet e veprimtarisë së NJAB Kucove për 3-vjeçarin 2026-2028 do të jenë:

- Angazhimi maksimal i burimeve dhe kapaciteteve në dispozicion për realizimin e plan-detyrave si për numurin dhe llojin e auditimeve që janë parashikuar në Planin Strategjik afatmese. Prioriteti është rritja e dhenies së sigurisë objektive menaxhimit të lartë të bashkisë, mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar e kontrollin
- Rritja e kërkesës për subjektet e audituara, dhe monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna e të pranuar për permiresimin e veprimtarive të tyre në përputhje me aktet ligjore, rregullatore e procedurave, me synim për të optimizuar realizimin e pritshmerisë së publikut si dhe për të siguruar dobinë, frytshmërinë dhe kursimin e veprimeve ekonomiko e financiare.
- Të ndihmojë menaxhimin e subjekteve që do të auditohen dhe të ofroje keshillim dhe mundësi njohje e implementimi për rritjen e nivelit të funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollin.

- Te angazhohemi ne zbatimin e Standardeve Globale te Auditimit te Brendshem dhe te rritim e permiresojme vijueshmerisht aftesite dhe kompetencat profesionale nepermjet studimeve ne dinamiken e tyre, pjesmarjes ne trajnimet apo cdo forme tjeter qe organizohet nga DH/AB e Ministrise se Financave
- Nepermjet rritjes profesionale dhe bashkepunimit me menaxheret e njesive përberese te minimizojmë dhe eliminojmë mundësitë për mashtrim, shpërdorim dhe abuzim të aseteve të subjekteve audituese .

II. PLANI VJETOR I AUDITIMIT NJ.A.B KUCOVE 2026

Bazuar në Kreun V neni 14, pika c te ligjit 114/2015 datë 22.10.2015 “*Për Auditimin e Brendshem në Sektorin Publik*”i ndryshuar, ne mbeshtetje te Standardeve Globale te AB miratuar me Urdherin nr.103 date 23.07.2025 te Ministrit te Financave, ne zbatim te Manualit te Auditimit te Brendshem, Kreu III “Plani Vjetor i Auditimit”, si dhe ne vleresim te kerkeses per vemendje “*ne permbushjen e kerkesave baze te kuadrit ligjor ne procesin e hartimit dhe dorezimit te Planit Strategjik e atij Vjetor*”, **derguar nga DH / AB me shkresen nr.13111 prot. date 19.09.2024**, njeheresh ne vijueshmeri e ne perputhje me planifikimin strategjik te relatuar me larte, NjAB Kucove ka parashikuar veprimtarin e saj duke hartuar:“Planin Vjetor të veprimtarise se auditimit për vitin 2026”

Plani vjetor i auditimit paraqet dokumentin kryesor, bazuar ne të cilin planifikohet e do te realizohet veprimtaria e NjA.B Kucove gjatë vitit pasardhes.

Programimi i aktiviteteve audituese, për vitin 2026, gjithashtu eshte hartuar në përputhje me burimet njerëzore dhe materiale në dispozicion të NjAB-së.

Ky program vjetor i veprimtarise, njeheresh vjen i dakordësuar me qendrimin e synimet e Kryetarit te Bashkise Kucove. sikurse plani strategjik i auditimit të brendshëm pemendur me siper.

Nj.A.B bashkia Kucove , ka hartuar Planin Vjetor të Auditimit për vitin 2026, ne respektim te kerkesave, metodologjise dhe formateve te percaktuara ne Manualin e Auditimit te Brendshem, dhe konkretisht sipas struktures vijuese :

- Zhvillimet aktuale të NJAB
- Prioritetet e auditimit
- Objektivi (at) kryesore
- Programimi i llojit të angazhimeve
- Planifikimi i kostos
- Planifikimi i burimeve
- Planifikimi i nevojave të stafit për trajnim
- Sigurimi i brendshëm i cilësisë

- **Zhvillimet aktuale të NJAB Kucove**

Veprimtaria e Njesise se Auditimit te Brendshem ne Bashkinë Kucove për periudhën Janar 2025 e ne vijim deri ne kohen e hartimit te ketij planifikimi, eshte realizuar ne mbeshtetje te Ligjit nr 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”, ne funksion e ne perputhje me legjislacionin “Per auditimin e brendshem ne sektorin publik”, si dhe ne zbatim te Planit Vjetor te veprimtarise se NJAB per vitin 2025, miratuar me dokumentin nr.3501 prot date 17.10.2024, te Kryetarit te Bashkise Kucove. Eshte patur ne vemendje te vijueshme, produkti i synuar: qe nga gjetjet dhe rekomandimet e dhena ne auditmet e realizuara te mund te jape ndikimin real per permiresimin e veprimtarise se administrates se bashkise ne funksion te permbushjes se objektivave te vendimuara dhe pritshmerive se komunitetit.

a- Organizimi aktual dhe permiresimi i aftesive profesionale te audituesve:

1. NjAB e Bashkise Kucove eshte e organizuar si **Sektor ne varesi te drejtperdrejt te Kryetarit te Bashkise**, me strukture prej 3 punonjesish (Pergjegjes i NjAB dhe 2 auditues);
2. Per vitin referues 2025, struktura e vendimuar per NJAB prej 3 punonjesish , ka qene dhe vijon te jete e plotesuar me funksionimin e 3 audituesve,pra jemi ne kushtet e ne perputhje me kriterin e detyrueshem ligjor, qe NJAB te perbehen prej jo me pak se 3 punonjes;
3. Ne kuader te kerkeses specifike detyruese- ligjore te auditimit, vetem Pergjegjesi i NjAB Kucove eshte i certifikuar si “Auditues i Brendshem ne sektorin publik”.Dy specialistet auditues te NJAB Kucove, vijojne te jene te pacertifikuar dhe ende jo ne proces certifikimi.
4. Ka vijuar gjate gjithë periudhes njohja, studimi dhe perditesimi nga punonjesit e Sektorit te A.B i legjislacionit te auditimit te brendshem, te menaxhimit financiar e kontrollit, si dhe ka patur vemendje te shtuar per azhornimin te organizimit e veprimtarise te bashkise Kucove e strukturave te saj perberese. Kjo ka qene domosdoshmeri pasi punonjesit aktuale te njesise se auditimit nuk kane pervojen dhe aq me pak ekspertizen e duhur ne universin e auditimit.

b- Faza e realizimit te angazhimeve te auditimit te brendshem:

1. Pas mbylljes se angazhimit ne terren te auditimit ne Njesine Administrative Perondi, auditim I programuar per vitin 2024, (auditim ky qe e mbylli veprimtarine ne terren me 26 dhjetor 2024), nga NjAB ne bashkepuniom me subjektin e audituar u ndoqen dhe u zbatuan te gjitha fazat e raportimit, duke perfunduar ne muajin Shkurt 2025, me Raportin Final si dhe Plan-Vepriimin e zbatimit te rekomandimeve nga njesia e audituar, ne kuader te permiresimit te veprimtarise se kesaj njesie..
2. Me Programin e angazhimit te auditimit “ me nr.1198 prot dt.08.04.2025 ,u realizua auditimi me baze sistemi i llojit financiar dhe i perputhshmerise“i kombinuar”, I veprimtarise se Drejtorise se Qendres se Kultures te bashkise Kucove. Duke respektuar standardet e kerkesat e percaktuara ne MAB, u realizuan te gjitha fazat e veprimtarise audituese dhe u respektuan afatet ligjore.
3. Bazuar ne kerkesat ligjore te AB, me specifikisht te Udhezimit nr.42 date 27.10.202, ne kuader te zbatimit te rekomandimeve te dhena nga kontrolli i DH/AB, u realizua angazhimi i auditimit te zbatimit te rekomandimeve. Me Programin e angazhimit te auditimit nr.1642 date 22.05.2025 Grupi i auditimit i caktuar, realizoi auditimin e zbatimit te rekomandimeve te dhena, dhe duke respektuar specifikat e afatet dokumentoi konkluzionet per Kryetarin e Bashkise
4. Bazuar ne “Programin e Angazhimit te Auditimit” me nr.2763 prot date 14.08.2025, po permyllet misioni i auditimit ne Inspektoratin e Mrojtjes Territorit, duke u kujdesur ne ndjekjen e procedurave standarde te ketij auditimi si dhe respektimin e afateve.

Prioritetet e auditimit për vitin 2026

- NJAB ne bashkine Kucove për vitin 2026, ka si prioritet realizimin e 6 misioneve të auditimit, mbështetur në standartet, metodologjine e auditimit të brendshëm në sektorin publik dhe parimet e auditimit , në mënyrë objektive dhe të pavarur.
- Dhenia e rekomandimeve nga auditimet e sigurise dhe ofrimi i keshillave per ngritjen e permiresimin e sistemit te Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin.
- Rritjen e permiresimin e aftësive profesionale dhe kompetencës së audituesve nepermjet ndjekjes se detyrueshme te Programit te Certifikimit “Auditues i Brendshem”, per specialistet auditues te pacertifikuar, dhe pjesmarjes ne trajnimin detyrueshëm profesional organizuar nga DH/AB, per punonjesit e NjAB-se Kucove

Objektivi (at) kryesore te NJAB Kucove për vitin 2026.

Objektivat kryesore te cilat synon te arrije NJAB Kucove, gjate vitit ne vijim jane:

- Te mbuloje me auditimin e e brendshem, njesite, sistemet apo fushat te cilat jane te planifikuara per tu audituar ne Planin Vjetor 2026.
- Të kryejë auditime të pavarura dhe objektive në përputhje me standartet, metodat, teknikat dhe parimet e auditimit të brendshëm në sektorin publik
- Nepermjet dhenies e ndjekjes se rekomandimeve të ndihmojë subjektet e audituara që në veprimtarinë e tyre të zbatojnë me përpikmëri dispozitat ligjore, rregullat dhe procedurat e vendosura për të siguruar dobinë, frutshmërinë dhe kursimin e veprimeve ekonomike financiare .
- Të ndihmojë subjektet e audituara për arritjen e qëllimeve dhe objektivave të vendosura nëpërmjet përmirësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar
- Ti japi siguri objektive Kryetarit te Bashkise mbi saktësinë e besueshmërinë e raporteve financiare dhe raporteve të performancës të pregatitura nga strukturat e menaxhimit.
- Të minimizojë dhe eliminojë mundësitë për mashtrim,shpërdorim dhe abuzim të aseteve publike.
- Te permiresoje aftesite e kapacitetet profesionale te specialisteve auditues nepermjet ndjekjes te Programit te Certifikimit “Auditues i Brendshem” per audituesit e pacertifikuar dhe pjesmarjes ne trajnimet qe organizon DH/AB si dhe studimit te vijueshem te legjislacionit ne dinamiken e tij..

Ne Planifikimin Vjetor 2026, duke qene pjese e Planit Strategjik 2026-2028, sigurohemi qe percaktimi i njesive, sistemeve dhe fushave kryesore per tu audituar, eshte bere duke mare ne konsiderate objektivat strategjike dhe prioritetet e bashkise Kucove.

Planifikimi i veprimtarise audituese te NJAB Kucove per vitin 2026, konsiston ne programimin e 6(gjashte) auditimeve me baze sistemi, si dhe ofrimin e keshillimeve te kerkuara apo sygjerimeve te veteofruara.Te dhenat me te hollleshme mbi subjektet dhe llojin e auditimit jane pasqyruar ne Pasqyren nr.3 (bashkengjitur ketij dokumenti)

Gjate planifikimit eshte treguar kujdes per ruajtjen e nje frekuence te arsyeshme per auditimin e subjekteve, pershtatjen e strategjise audituese me ndryshimet ne politikat,procedurat e strukturen e bashkise, si dhe ne koordinimin me ofruesit e jashtem te sigurimit te cilesise si KLSH etj.

- **Programimi i llojit të angazhimeve**

Për vitin 2026 janë parashikuar të kryhen 6 angazhime auditimi, nga të cilat: 1(nje) subjekt njesi administrative , nderkohe jane 4(kater) fusha auditimi brenda Bashkisë: (Drejtoria e Finances, Drejtoria e Sherbimeve Publike, Dr. Planifikimit & Zhvillimit Territorit; Dr, Zhvillimit Rural), si dhe 1(nje) auditim i zbatimit te rekomandimeve te dhena ne vitin paraardhes.

Sa i perket llojit te auditimit, nga 6 angazhime auditimi te planifikuara gjithsej, janë programuar 4 auditime te përputhshmërisë; 1 auditim i kombinuar(financiar dhe i perputhshmerise) dhe 1 auditim i ndjekjes se zbatimit te rekomandimeve te dhena..

NJAB mbështetur në organizimin e subjekteve që do të auditohen, në burimet financiare,materiale dhe njerëzore si dhe në aktivitetin (veprimtarinë) që ushtrojnë këto subjekte ka parashikuar realizimin e 6-7 angazhime auditimi cdo vit, sipas llojit të auditimeve të pasqyruara në pasqyren nr.3, për të gjitha subjektet, fushat e llogarisë, sistemet dhe llogaritë individuale të cilat justifikojnë burimet e NJAB, për një numër punonjësish prej 3 veta.

- **Planifikimi i koston për vitin 2026**

Për vitin 2026 në pasqyrën nr.5 është përlogaritur kostua e Buxhetit që i nevojitet NJ.A.B bashkia Kucove për realizimin e veprimtarisë audituese për 3 punonjës, konkretisht :

-Paga dhe sig.shoq në shumën 3 550 00 lekë

-Shpenzimi udhëtimi e dieta në shumën 90 000 lekë

-Shpenzime të tjera në shumën 60 000 lekë

-Numri i punonjësve 3, me një kosto mesatare vjetore për person në shumën 1 233 500 lek/punonjes/vit

Planifikimi i buxhetit për ushtrimin e veprimtarisë të NJAB bashkia Kucove, në shumën 3 700 000 lekë është i nevojshëm dhe efektiv për realizimin e kësaj veprimtarie .

- **Planifikimi i burimeve njerëzore për vitin 2026**

NJAB Kucove në pasqyrën nr.5 ka llogaritur dhe nevojat e burimeve për realizimin e 6 angazhime auditimi të programuara për vitin 2026, duke përcaktuar edhe shpërndarjen e burimeve njerëzore të NJAB,të tillë si :

Koha maksimale e vlefshme për realizimin e programit vjetor të auditimit është 260 dite efektive x 3(tre) punonjes = 780 ditë/njërëz, nga të cilat duhet te zbriten shuma e dite/njerez sipas arsyeve te meposhtme :

- pushime vjetore te paguara : 3 punonjes x 22 dite = 66 ditë/njërëz,
- festa zyrtare 3 punonjes x 16 dite = 48 ditë/njërëz,
- pushime për arsye shëndetësore 3 punonjes x 5 dite = 15 ditë/njërëz,
- angazhime në trajnime 3 punonjes x 5 dite = 15 ditë/njërëz,
- angazhime në mbledhje takime 3 punonjes x 4 dite = 12 ditë/njërëz
- dhe rezerva të planifikuara (të papritura) = 15 ditë/njërëz.
- **TOTALI i zbritshem.....= 171 dite/njerez**

Totali i burimeve njerëzore te Njesise Auditimit te Brendshem, të vlefshme për realizimin e programit të veprimtarisë audituese per vitin 2026, është 609 ditë/njërëz(per 3 punonjes) ose 203 ditë përperson .

- **Planifikimi i nevojave të stafit për trajnim**

NJAB Kucove për ngritjen profesionale të audituesve të brendshëm mbështetur në ligjin 114/2015 datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” te ndryshuar, për trajnimin e detyrueshëm të audituesve në masën 40 orë në vit, ka planifikuar nevojat për trajnimin e detyrueshëm për të 3 audituesit sipas **pasqyrës nr.4**, bashkëngjitur këtij programi, duke pasur parasysh edhe rekomandimet e vijueshme të Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, në funksion dhe të implementimit të direktivave të Bashkimit Europian për veprimtarinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Krahas kualifikimit të detyruar auditët do të punojnë edhe individualisht për ngritjen e tyre profesionale nëpërmjet studimit të vijueshëm të manualit, standarteve dhe udhëzimeve të auditimit të brendshëm në sektorin publik si dhe të studimit të dispozitave ligjore të çdo subjekti apo fushe auditimi që përfshihen në programin vjetor të auditimit.

Sigurimi i brendshëm i cilësisë

Mbështetur në Manualin e Auditimit të Brendshëm, kapitulli IV “Raportimi dhe komunikimi i auditimit. Sigurimi i cilësisë së punës”, pika 4.8, NJAB Kucove do të realizojë sigurimin e cilësisë së punës të auditimeve të kryera për çdo subjekt apo fushë auditimi me qëllim që të sigurohemi se të gjitha angazhimet e auditimit përmbushin standartet dhe janë të dobishme për subjektin e audituar.

Sigurimi i cilësisë të auditimit gjatë fazave të veprimtarisë audituese do të realizohet nga Përgjegjësi i Nj.A.B. Rishikimi i cilësisë së auditimeve të kryera do të bëhet me program të vecantë dhe në përfundim do të jepen rekomandime për përmirësimin e cilësisë aty ku vërehen mangësi e defekte në zbatimin e standarteve të auditimit.

Ne përfundim :

Ne kuader të detyrimeve të percaktuara në Planin Strategjik për vitet 2026 – 2028, dhe zbatimin e Planit Vjetor të Auditimit për vitin 2026, Njësia e Auditimit të Brendshëm në bashkinë Kucove do të punojë me përkushtim, përgjegjësi e profesionalizem duke u mbështetur në parimet kryesore të auditimit: Të ligjshmërisë, pavarësisë, paanësisë, konfidencialitetit, si dhe në zbatim të kërkesave të ligjit nr.114/2015 datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” të ndryshuar, Standardeve Globale të AB dhe metodologjisë së Manualit të Auditimit të Brendshëm, “Kartës së Auditimit të Brendshëm” dhe Kodit të Etikës për punonjësit e auditimit të brendshëm.

Bashkelidhur do të gjeni Pasqyrat shoqeruese sipas formatet e miratuara :

- Pasqyra nr. 1 “Vlerësimi i nivelit të riskut për të gjitha subjektet sipas strukturae së miratuar”.
- Pasqyra nr. 2 “Plani strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar për vitet 2026-2028.”
- Pasqyra nr. 3 “Plani i angazhimeve të auditimeve sipas subjekteve për vitin 2026.”
- Pasqyra nr. 4 “Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NJ A B Kucove për vitin 2026 .”
- Pasqyra nr. 5 “Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2026”.

Ju faleminderit për bashkepunimin !

NJESIA E AUDITIMIT TE BRENDSTEM

ADRIATIK CARKA

